

FJALA E DEPUTETIT NIKO PELESHI

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

E nderuara zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Miratimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Ndërkombëtare për Ndhmat Detare në Lundrim” do t’i japë mundësi kompletimit të kuadrit ligjor për sa i përket sigurisë në lundrimin detar në Republikën e Shqipërisë. Angazhimi i Shqipërisë në një organizatë ndërkombëtare, siç është Organizata Ndërkombëtare e Autoriteteve të Ndhmës në Lundrim dhe Sinjalistikës Detare, me akronimin IALA, do të luajë një rol mjaft të rëndësishëm për sa i përket vendosjes së Shqipërisë në hartën gjeografike të vendeve të sigurta. Kjo jo vetëm për qytetarët e saj, por parë edhe në këndvështrimin e turizmit.

Më lejoni që me pak fjalë t’ju informoj për gjenezën e kësaj organizatë. Bazuar në dispozitat e konventës ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për ligjin për detin, si dhe të konventës ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det dhe me anë të rezolutës së datës 27.05.2014 Republika e Francës propozoi që kjo organizate, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe arritjen e objektivave të saj të kishte statusin e një organizate ndërkombëtare dhe ky status do të arrihej përmes zhvillimit të një konvente ndërkombëtare. Aktualisht, sipas të dhënave të marra nga IALA, Konventa për Organizatën Ndërkombëtare për Ndhmat Detare në Lundrim është firmosur nga 51 shtete. Nisma për aderimin e Republikës së Shqipërisë në këtë organizatë është e Ministrisë së Mbrojtjes së bashku edhe me mbështetjen e institucionit tonë që do të jetë në vijë të parë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo konventë, që është shërbimi hidrografik i Komandës së Forcës Detare dhe Forcave të Armatosura.

Ju sjell në vëmendje që para pak kohësh kemi miratuar edhe ligjin për aderimin e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Hidrografisë, kështu që së bashku me projektligjin e sotëm, që

jam i bindur se do ta votojmë së bashku, ne plotësojmë kuadrin ligjor të lundrimit të sigurt. Ajo që përbën pjesën më të rëndësishme në këtë proces, janë përfitimet e Republikës së Shqipërisë nga anëtarësimi në këtë organizatë, që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe rritjen e sigurisë në hapësirën detare shqiptare, ruajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, ndikimin dhe sigurimin e ekonomisë detare, ndikimin dhe zhvillimin ekonomik, zhvillimin e marrëdhënieve shumëpalëshe me shtetet aleate të rajonit dhe më gjerë.

Edhe sot që flasim, në mënyrë vullnetare, ne i zbatojmë rregullat e lundrimit të sigurt, por anëtarësia në këtë organizatë na jep edhe akses në trajnime për rritjen e kapaciteteve, apdejtimin apo rifreskimin e teknologjisë dhe, pa dyshim, mundësinë për të partnerizuar dhe për të zgjeruar rrjetin e bashkëpunimit edhe me shtete dhe organizata të tjera. Anëtarësimi në Organizatën Ndërkombëtare për Ndihamat Detare në Lundrim do të mundësojë plotësimin akoma më të plotë të kuadrit ligjor në fushën e detarisë dhe hidrografisë dhe do t'i sjellë vendit një ambient më të sigurt dhe të zhvilluar si në fushën e mbrojtjes, ashtu edhe në fushën e turizmit apo infrastrukturës lundruese.

Së bashku me përfitimin, natyrisht që ka edhe një tarifë, e cila është 17 670 euro në vit, që do të përballohet nga buxheti i ministrisë dhe është vendosur se do të ketë një rritje me 3% në vit. Dua ta mbyll fjalën time duke ju falënderuar për kontributin e dhënë në diskutimet në komisione; në disa prej tyre kam marrë pjesë dhe ju ftoj ta votojmë këtë projektligj!  
Faleminderit!